



DREJTORIA PËR FINANCA, EKONOMI DHE ZHVILLIM

05-Nr 432-4925 /2020

Klinë, datë 06.02.2020

NJOFTIM

PËR OBLIGUESIT E TATIMIT NË PRONË PËR TE PUNËSUARIT NË SEKTORIN PUBLIK (ADMINISTRATË KOMUNALE, ARSIM DHE SHËNDETËSI)

Njoftohen të gjithë të punësuarit në sektorin publik përkatësisht në të gjitha Drejtoritë e Administratës komunale, në Arsim dhe Shëndetësi të cilët kanë borxhe nga tatimi në pronë deri me 31.12.2019 në vlerë mbi 100,00 euro që t'i përmbushin këto obligime deri 30 prill 2020, kur edhe skadon afati për pagesën e kistit të parë të tatimit në pronë për vitin 2020.

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, në bazë të kompetencave të veta, pas kalimit të këtij afati do të inicioj procedurat ligjore që parashihen me LIGJIN NR. 03/L-204 PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME, për inkasim të detyrueshëm, përfshirë edhe masën e bllokimit të xhirollogarive deri në përmbushje të obligimit tatimor.

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim ka evidencën e saktë të të punësuarëve që kanë obligime tatimore të pakryera, të cilat do të jenë në dispozicion për të gjithë të interesuarit dhe në Zyrën e tatimit në pronë në çdo kohë mund të njoftohen mbi gjendjen e borxhit.

Ju inkurajojmë dhe shpresojmë për përmbushjen vullnetare të obligimeve tuaja deri me datën 30 prill 2020 në mënyrë që të mos jemi të detyruar për masën e inkasimit të detyrueshëm.

Shfrytëzoheni këtë periudhë kohore deri me 30 prill 2020 për kryerjen e këtij obligimi qytetar.

Ju mirëpresim,
Me respekt,



Drejtori
Aziz Desku